

LIGJ
Nr.7659, datë 12.1.1993

PËR FARAT DHE FIDANËT

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 19.2.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Farat, fidanet, copat, filizat, zhardhokët, bulbat, kamzat, llastunjat dhe çdo pjesë tjetër e bimës që shërben për mbjellje dhe riprodhimin e tyre, për efekt të këtij ligji, do të përfshihen në termin "Material mbjellës bimor".

Neni 2

Materiali mbjellës bimor klasifikohet në këto kategori:

- a) Material mbjellës gjenetik (popullata, ekotipet, biotipet, linjat, incuktlinjat dhe klonet).
- b) Materiali mbjellës bimor i krijuar (kultivar i ri, linjat prindërore të reja, hibride të reja e klone të rinj në pemëtari).
- c) Material mbjellës bimor bazë (supersuperelitët, superelitët, elitët e të gjitha kategorive, si dhe hibridet).
- ç) Material mbjellës bimor për shumëzim e prodhim (të gjitha farat e riprodhimeve të para e të dyta).

KREU II
KRIJIMI, RIPRODHIMI DHE SHUMËZIMI I MATERIALIT
MBJELLËS BIMOR

Neni 3

Të drejtën e krijimit të materialit të ri mbjellës bimor sipas nenit 2, shkronja "b" e këtij ligji, me qëllim përhapje e tregtimi, e kanë institucionet kërkimore - shkencore dhe arsimore shtetërore ose private, vetë ose në bashkëpunim me të huaj, si dhe personat juridikë e fizikë vendas, vetë ose në bashkëpunim me të huaj. Personat juridikë e fizikë të huaj e gëzojnë këtë të drejtë për të gjitha rastet vetëm me leje të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 4

E drejta e dhënies së lejes, detyrat dhe të drejtat që kanë personat juridikë e fizikë që meren me krijimin, riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës bimor, përcaktohen me rregullore të veçantë të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, kurse kushtet e standartizimit, rregullat dhe normat e treguesve cilësorë, të marketimit, ambalazhimit, etiketimit, transportimit e të ruajtjes përcaktohen nga organi qendror i standartizimit dhe i cilësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 5

Krijuesit të çdo materiali të ri mbjellës sipas nenit 2, shkronja "b" i këtij ligji, i njihet e drejta e autorësisë, e cila i garantohet me ligj. Ajo regjistrohet dhe lëshohet nga Enti shtetëror i farërave dhe i fidanëve, mbi bazën e vendimit të Komisionit të atestimit të kultivarëve dhe hibridëve të rinj që funksionon pranë këtij Enti, sipas nenit 14 të këtij ligji. Nuk lejohet shfrytëzimi i së drejtës së autorit nga persona fizikë e juridikë të tjerë, pa autorizimin e tij.

Neni 6

Riprodhimi dhe shumëzimi i materialit mbjellës bimor sipas shkronjave "c" dhe "ç" të nenit 2 të këtij ligji lejohet nga çdo krijues i materialit të ri mbjellës, si dhe nga çdo person fizik e juridik vendas a i huaj, ose në bashkëpunim ndërmjet tyre, me kusht që:

a) Të merret leje për riprodhimin dhe shumëzimin e farave ose për prodhimin e fidanëve, sipas nenit 4 të këtij ligji.

b) Materiali mbjellës bimor që riprodhohet e shumëzohet, të jetë regjistruar në Regjistrin themeltar të kultivarëve e hibrideve të llojeve të bimëve të kultivuara.

c) Të sigurohet zbatimi i kushteve të domosdoshme agroteknike për riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës bimor.

Neni 7

Riprodhimi dhe shumëzimi i materialit mbjellës bimor për llogari të personave juridikë e fizikë të huaj, pa qenë i regjistruar në regjistrin themeltar të farave dhe fidaneve, bëhet vetëm me leje të Entit, të miratuar nga ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit.

KREU III TREGTIMIN I MATERIALIT MBJELLES BIMOR

Neni 8

Tregtimi i materialit mbjellës bimor lejohet nga të gjithë personat juridikë e fizikë që kanë të drejtën e krijimit të materialit mbjellës bimor sipas nenit 3 dhe të riprodhimit e shumëzimit të tij sipas nenit 6 të këtij ligji, si dhe nga çdo person juridik e fizik që në mbështetje të dispozitave të tjera ligjore në fuqi është pajisur me leje për të ushtruar veprimtari në tregti.

Neni 9

Materiali mbjellës bimor tregtohet kur:

a) I përket një kultivari, hibridi ose kloni që është regjistruar në Regjistrin themeltar të kultivarëve dhe hibrideve të llojeve të bimëve të kultivuara dhe nuk i ka kaluar afatet e lejimit të tij për tregti e mbjellje.

b) Shoqërohet me certifikatën e kontrollit mbi treguesit cilësorë të farës dhe certifikatën fitosanitare.

c) I përgjigjet standarteve shqiptare për treguesit cilësorë e fitosanitarë si material mbjellës bimor.

Në raste të jashtëzakonshme për llojet e kontigjenteve të caktuara, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit dhe me autorizim të emërtesës së standarteve, lejohet tregtimi dhe mbjellja e materialit mbjellës bimor me tregues cilësorë nën ata të përcaktuar në standartet shqiptare.

Neni 10

Nuk lejohet tregtimi dhe mbjellja e çdo lloj materiali mbjellës bimor që është infektuar me sëmundje e dëmtues që janë objekt karantine, si dhe i bimëve nga të cilat prodhohen narkotikë ose lëndë helmuese e që përcaktohen në rregulloret e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 11

Institucionet shkencore e arsimore, Enti shtetëror i farërave dhe fidanëve, si dhe subjekte të tjera që merren me krijimin e ruajtjen e materialit mbjellës bimor sipas nenit 3 të këtij ligji, vetëm me urdhër të titullarit të institucionit, kanë të drejtë të shkëmbejnë material mbjellës bimor në sasi të vogla për qëllime shkencore e eksperimentale me institucionet shkencore brenda ose jashtë vendit, apo persona fizikë e juridikë të huaj, pa iu nënshtruar licencës dhe rregullave doganore, përveç materialit mbjellës me vlera të veçanta gjenetike.

Kufijtë e sasive të farave sipas llojeve që lejohen të shkëmbehen për këtë qëllim, si dhe ato që ndalohen, përcaktohen në rregulloren e Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

KREU IV KONTROLI PËR CILESITË E MATERIALIT MBJELLES BIMOR DHE RUAJTJA E MATERIALIT GJENETIK

Neni 12

Në Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit krijohet Enti shtetëror i farërave dhe fidanëve për organizimin e kontrollit të materialit mbjellës bimor në të gjitha hallkat dhe të ruajtjes së materialit gjenetik.

Neni 13

Nëpërmjet organizimit të rrjetit zonal të provave krahasuese të materialit mbjellës bimor dhe metodave laboratorike, ky Ent kontrollon vërtetësinë e treguesve sasiore e cilësorë të prodhimit dhe të atyre gjenetikë të çdo materiali mbjellës të ri bimor, të krijuar në vend sipas shkronjës "b" të nenit 2 të këtij ligji, si dhe çdo materiali mbjellës bimor të ri të ardhur nga jashtë për riprodhim e shumëzim.

Neni 14

Komisioni i atestimit të farërave dhe fidanëve që funksionon pranë këtij Enti e që caktohet me urdhër të ministrit të Bujqësisë e të Ushqimit, mbi bazën e rezultateve sipas nenit 13 të këtij ligji, bën vlerësimin dhe jep miratim për regjistrimin e materialit të ri mbjellës bimor dhe jep leje për riprodhimin, shumëzimin dhe tregtimin e tij.

Neni 15

Të gjitha analizat zyrtare për tregues cilësorë si material mbjellës bimor për çdo kontigjent fare, kryhen në Laboratorin Qendror të farave dhe në ato të rretheve që varen nga ky ent dhe mbi këtë bazë lëshohet certifikata e cilësisë dhe fitosanitare duke shënuar në të se ky material mbjellës lejohet ose jo për mbjellje. Sasitë për çdo kontigjent sipas llojeve dhe treguesve cilësorë që analizohen, përaktohen në rregulloret e veçanta të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

Neni 16

Ndalohet importimi i materialit mbjellës për qëllime riprodhimi, shumëzimi e tregtimi nga çdo person juridik e fizik vendas a i huaj, pa qenë i pajisur me leje, përveç rasteve të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

Enti shtetëror i farave dhe fidanëve është i vetmi organizëm shtetëror që ka të drejtën e dhënies së lejes për importimin e çdo lloj materiali mbjellës bimor, si dhe për eksportimin, kur ky bëhet i kontrolluar nga shteti.

Neni 17

Enti Shtetëror i Farave dhe i Fidanëve me miratim të ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit organizon lidhjen, integrimin dhe anëtarësimin me organizmat ndërkombëtarë, që merren me trajtimin e materialit mbjellës bimor, me bankat gjenetike, si dhe me organizmat homologe të vendeve të tjera.

Neni 18

Sistemi shtetëror i ruajtjes, mbrojtjes dhe trajtimit të materilit mbjellës gjenetik sipas shkronjës "a" të nenit 2 të këtij ligji, organizohet nga Enti Shtetëror i Farave dhe i Fidanëve, nëpërmjet Bankës Gjenetike.

Neni 19

Inspektoriati i farërave dhe i fidanëve që funksionon pranë këtij Enti, nëpërmjet inspektorëve të tij në qendër e në rrethe, ushtron kontroll sistematik në të gjitha instancat kur riprodhohet, shumëzohet e tregtohet çdo lloj materiali mbjellës bimor për:

- Zbatimin e dispozitave në fuqi të këtij ligji e të rregulloreve përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit.

- Zbatimin e standarteve shqiptare të farave dhe fidanëve.

- Respektimin e rregullave fitosanitare; për këtë bashkëpunon me shërbimin e karantinës dhe të mbrojtjes së bimëve.

- Respektimin e kushteve të domosdoshme agroteknike për riprodhimin dhe shumëzimin e materialit mbjellës bimor.

Mbajtjen e dokumentacionit të domosdoshëm teknik në të gjitha hallkat e riprodhimit, shumëzimit e të tregtimit të materialit mbjellës bimor.

Neni 20

Inspektorët e farërave dhe të fidanëve në rrethe, pas verifikimit të dokumentacionit të materialit mbjellës bimor dhe të kontrolleve periodike në ngastrat e riprodhimit e të shumëzimit të tij, bëjnë aprobimin fushor. Pa këtë aprobim çdo material mbjellës bimor i ardhur nga prodhuesi nuk mund t'i nënshtrohet analizave zyrtare për treguesit cilësorë dhe të çertifikohet.

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 21

Për shkelje të dispozitave që parashikon ky ligj, inspektorët e farërave dhe të fidanëve, si dhe personat e tjerë të autorizuar nga ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit, kanë të drejtën e gjobës nga 500 deri në 10 000 lekë si dhe të pezullimit të përkohshëm ose të ndalimit të riprodhimit, shumëzimit dhe tregtimit të materialit mbjellës bimor.

Neni 22

Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, te kryeinspektori i Entit shtetëror të farërave dhe fidanëve, vendimi i të cilit është i formës së prerë.

Neni 23

Mashttrimet në kultivarë, hibride, linje dhe në riprodhim për qëllime spekulimi, riprodhimi, shumëzimi e tregtimi i materialit mbjellës bimor, nga i cili prodhohen narkotike ose lëndë helmuese, si dhe dhënia pa leje e materialit mbjellës gjenetik me vlera të veçanta për vendin personave juridikë e fizikë të huaj, dënohen sipas Kodit Penal.

Neni 24

Dispozitat e këtij ligji kanë fuqi vepruese për materialet mbjellëse bimore të të gjitha llojeve të bimëve të kultivuara, duke përfshirë edhe ato pyjore, si dhe kërpudhat e kultivuara për ushqim.

Neni 25

Në zbatim të këtij ligji, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit të nxjerrë rregulloret përkatëse për krijimin, shumëzimin, tregtimin dhe kontrollin e çdo lloj materiali mbjellës bimore, si dhe për ruajtjen, mbrojtjen dhe tregtimin e materialit mbjellës gjenetik.

Neni 26

Ligji nr.6225, datë 22.6.1988 "Për organizimin e prodhimit e të shpërndarjes së farave e fidanëve drufrutore", si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohet.

Neni 27

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.439, datë 26.1.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha